UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 136/3, datë 15.2.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 34, DATË 29.12.2014, "PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PAJISJEN ME LEJEDREJTIMI"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", ministri i Financave dhe ministri i Transportit dhe Infrastrukturës në udhëzimin nr. 34, datë 29.12.2014, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për pajisjen me lejedrejtimi", udhëzojnë ndryshimin si më poshtë:

1. Tarifa e pajisjes me lejedrejtimi për drejtimin e automjeteve është si më poshtë:

a) për lejedrejtimi të kategorisë AM, A1, A2, A 3000 (tre mijë) lekë;

b) për lejedrejtimi të kategorisë B1, B
4500 (katërmijë e pesëqind) lekë;

c) për lejedrejtimi të kategorisë C1, C
2000 (dy mijë) lekë;

ç) për lejedrejtimi të kategorisë D1, D
3000 (tremijë) lekë;

d) për lejedrejtimi të kategorive B96, BE, C1E, CE, D1E, DE
3000 (tre mijë) lekë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Sokol Dervishaj
MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj